



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 13

Tiranë – E martë, 19 prill 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6802, datë 12.4.2022	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të shoqërisë “Kamberi” sh.p.k.....	3
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6991, datë 14.4.2022	Për marrjen pjesë në Tryezën e Diskutimit dhe Këshillimit, në kuadër të procesit të integritetit evropian, për kapitullin 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”	3



NJOFTIM

Nr. 6802, datë 12.4.2022

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE NË
ADMINISTRIM TË SHOQËRISË
“KAMBERI” SHPK**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kreu III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në pronësi të shoqërisë “Kamberi” administrim sh.p.k.

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Moto Gjenerator, marka TROGENO-TORINO, e tipit MV nr. 118	Rruga “Pirro Godo”, Tiranë	110 000	11.5.2022	11:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të kenë tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën

për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

NJOFTIM

Nr. 6991, datë 14.4.2022

**PËR MARRJEN PJESË NË TRYEZËN
E DISKUTIMIT DHE KËSHILLIMIT,
NË KUADËR TË PROCESIT TË
INTEGRIMIT EVROPIAN, PËR
KAPITULLIN 2, “LËVIZJA E LIRË
E PUNËTORËVE”**

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit drejtues të kapitullit 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”, fton të marrin pjesë lirisht në Tryezën e Diskutimit dhe Këshillimit, në kuadër të procesit të integritetit evropian, e cila do të krijohet në mënyrë analoge me kapitujt e *acquis* të



Bashkimit Evropian, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit, referuar përcaktimeve të kreut III.2, pika 4 të urdhrit.

Sipas përcaktimeve të kreut III.2 të urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t'u bërë pjesë e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi, si dhe CV-së të personit apo të grupimit që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje, brenda datës 29 prill 2022, në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariatit teknik të GNP-së, si më poshtë:

Rezarta.Dashi@financa.gov.al dhe

Eva.Hamitaj@financa.gov.al.

Përzgjedhja e personave apo e përfaqësuesve të grupeve të interesit do të bëhet sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, nga Grupi Ndërinstitucional i Punës.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2022